



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
NJESIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. _____ Prot.

Kuçovë, më / 04 / 2026

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
KRESHNIK HAJDARI

PROGRAMI I SIGURIMIT TE CILESISE SE AUDITIMIT TE BRENDSHEM
NE BASHKINE KUCOVE PER VITIN 2026

HYRJE

Ky dokument vjen ne perputhje me Standardet Globale te Auditimit te Brenshem(SGAB) te miratuara nga IIA dhe te pranuar per tu zbatuar me Urdherin e Ministrit te Financave nr.103 date 23.07.2025, ne zbatim te Kreut XI te Manualit te Auditimit te Brendshem (I permiresuar) miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave nr.134 date 17.10.2025, si dhe praktikave me te mira te sudiuar per sigurimin e cilesise se veprimtarise audituese.

Qellimi I Programit te Sigurimit dhe Permiresimit te Cilesise se Auditimit(PSPC) :

PSPC hartohet per te nxitur permiresimin e vazhdueshem te funksionit te auditimit te brendshem ne bashkine Kucope, duke siguruar perputhshmëri me pritshmerine e Menaxhimit te Larte te bashkise, dhe duke permbushur kerkesat e Standardeve Globale te Auditimit te Brendshem 2024 (SGAB) te IIA-s.

Fushëveprimi i PSPC tenton te shtrihet pertej aktiviteteve te auditimit, duke perfshire te gjitha aspektet e funksionit te auditimit te brendshem. Ai kerkon te siguroje qe auditimet e brendshme jo vetem t'i permbahen standardeve te percaktuara, por edhe te ofrojne vlerë nêpermjet adresimit te risqeve organizative, duke permiresuar qeverisjen dhe performance.

Ndertimi dhe zbatimi I PSPC per funksionin e NJAB-së Kucope, synon te permiresojë vazhdimisht performancën e ketij sektori në planin afatgjatë duke u perqendruar në punën e auditimit, duke adresuar njêkohësisht nevojat e të gjitha palëve të tjera të interesuara per kete sherbim.

Objektivat e PSPC përfshijnë:

- Sigurimin e perputhshmërisë me Standardet Globale te AB dhe pajtueshmërinë me legjislacionin.
- Vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të auditimit të brendshëm.
- Promovimin e permiresimin e vazhdueshem per te permbushur pritshmeritë e palëve të interesuara.

Programi I Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë të NJAB Kucove për vitin 2026

Standardi SGAB	Titulli i Standardeve	Interpretim
8.3	Cilësia	<p>Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kucove do duhet të zhvillojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë që mbulon të gjitha aspektet e funksionit të auditimit të brendshëm. Programi përfshin dy lloje vlerësimesh:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimet e jashtme. • Vlerësimet e brendshme.
8.4	Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë	Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet njëherë çdo pesë vite nga një ekip vlerësuesish të DH/AB në Ministrinë e Financave.
9.3	Metodologjitë	Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm do duhet të vlerësojë efektivitetin e metodologjisë dhe përditësimin e tyre si të nevojshëm për përmirësimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe përgjigjet ndaj ndryshimeve të rëndësishme që ndikojnë në funksion.
12.1	<p>Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë</p> <p>a) Monitorim i vazhdueshëm</p>	<p>Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm do të zhvillojë dhe do të kryejë vlerësime të brendshme të përputhshmërisë së funksionit të auditimit të brendshëm me SGAB dhe ta çojë përpara drejt objektivave të performancës. Drejtuesi i NJAB Kucove do të krijojë një metodologji për vlerësimet e brendshme, siç përshkruhet në Standardin 8.3. Cilësia që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Monitorim i Vazhdueshëm; -Vetëvlerësimet periodike; -Komunikimi me titullarin për rezultatet e vlerësimeve të brendshme <p>Drejtuesi i NJAB do duhet të përfshijë monitorimin e vazhdueshëm në politikën dhe praktikën rutinë të përdorura për të menaxhuar funksionin e auditimit të brendshëm dhe përdorin procese, mjete dhe informacione të konsideruara të nevojshme për të vlerësuar përputhshmërinë me Standardet.</p> <p>Monitorimi i vazhdueshëm do të kryhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm. -Audituesit e brendshëm të NJAB (sipas rolit që kanë në Grupin e Auditimit) <p>Monitorimi do të përfshijë vendosjen e pritshmërive, nxitjen e komunikimit ndërmjet anëtarëve të grupit gjatë gjithë angazhimit dhe rishikimin dhe nënshkrimin në kohë të letrave të punës.</p> <p>Mekanizmat që do të përdoren për monitorim të vazhdueshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Listat e kontrollit për monitorim të vazhdueshëm do të jenë ato sipas Formati Standard nr.18 dhe nr.19 në Aneksin 3. -Reagime nga subjekti i audituar në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e grupit të auditimit të brendshëm duke përdorur Formatin Standard nr. 20 në Aneksin nr. 3. -Vendosja e monitorimit të treguesve specifike të performancës

	<p>b) Vetëvlerësime periodike</p>	<p>do te jete thelbësore për vlerësimin e cilësisë dhe efikasitetit të funksionit të auditimit të brendshëm, sipas Formatit Standard nr. 1 në Aneksin nr. 4.</p> <p>-Matjet e buxheteve të projekteve, sistemet e llogaritjes së kohës do të ndihmojnë në përcaktimin nëse shpenzohet sasia e duhur e kohës për të gjitha aspektet e angazhimit të auditimit.</p> <p>Vetëvlerësimet periodike janë ndërtuar për të vlerësuar përputhshmërinë e funksionit të auditimit të brendshëm me SGAB dhe progresin drejt objektivave të performancës, kartës së AB, kërkesave rregullatore dhe efikasitetin dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm në përmbushjen e objektivave të auditimit dhe nevojave të Kryetarit të bashkise.</p> <p>.</p> <p>Vetë-vlerësimet periodike do kryhen nga auditues të brendshëm që kanë marrë titullin Auditues i Brendshëm i Certifikuar. Drejtuesi i NJAB, duhet të marrë në konsideratë përfshirjen e audituesve të brendshëm në procesin periodik të vetëvlerësimit për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për standardet.</p> <p>Mjeti kryesor që do të përdoret për vetëvlerësim do të jenë Listat e Kontrollit, sipas Fomatit Standard nr.2 Aneksi 4 e Formatit nr.2/1 në Aneksin 4, të MAB 2025.</p> <p>Duke iu referuar kërkesave të standardeve për komunikim efektiv me Kryetarin e Bashkise, Drejtuesi i NJAB do të organizojë një vetë -vlerësim periodik, të paktën një herë në vit për të gjithë funksionin. Një qasje e tillë ofron një bazë vjetore siguri se puna e auditimit të brendshëm vazhdon të funksionojë në përputhje me kërkesat e SGAB dhe parimet e funksionit të auditimit të brendshëm.</p>
<p>12.2</p>	<p>Matja e Performancës</p>	<p>Drejtuesi i NJAB Kucove do përcaktojë objektiva për të vlerësuar performancën e funksionit të auditimit të brendshëm, duke marrë në konsideratë kontributin dhe pritshmëritë e menaxhimit të lartë kur zhvillon objektivat e performancës.</p> <p>Drejtuesi i NJAB, do të përcaktojë objektivat dhe masat e performancës, duke marrë në konsideratë kategoritë e mëposhtme:</p> <p>-Mbulimi i objektivave të angazhimit, që pritet të shqyrtohen sipas mandatit të auditimit të brendshëm.</p> <p>-Pajtueshmëria me kërkesat e Standardit 9.1 "Kuptimi i qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit"</p> <p>-Ai mbështet strategjia e funksionit të auditimit të brendshëm objektivat strategjike dhe suksesin e Bashkise dhe a është në përputhje me pritshmerine e Kryetarit të Bashkise dhe palëve të tjera të interesuara ? (Standardi 9.2“Strategjia e auditimit të brendshëm”)</p>

	Rishikimi dhe Përmirësimi i Proçesit	<p>-Adresimi i objektivave të rëndësishëm të njësisë publike,përmes opinionit të përgjithshëm të auditimit në nivel të njësisë publike.</p> <p>-A e mbështet plani i auditimit arritjen e objektivave të organizatës? Standardi 9.4, “Plani i auditimit të brendshëm”;</p> <p>-A bazohet plani i auditimit në një dokument vlerësimi të strategjive,objektivave,risqeve etj.të organizatës?</p> <p>-Përqindja e rekomandimeve ose planeve të veprimit të zbatuara nga menaxhimi,që çojnë në rezultate të dëshiruara dhe monitorohen nga funksioni i auditimit të brendshëm.</p> <p><i>-Proçeset e ndjekjes</i></p> <p>-Efektiviteti i veprimeve pasuese mbi Rekomandimet e auditimit;</p> <p>-Reagime nga të audituarit dhe palët e tjera të interesuara.</p> <p>Mjeti kryesor qe do te përdoret për matjen e performances do te jete Formati Standard nr.1në Aneksin 4 te MAB 2025, i cili përfshin,por nuk kufizohet në Listën e Treguesve të Performancës së funksionit të auditimit të brendshëm që duhet të jenë pjesë e PSPC</p> <p>Vemendje e shtuar do te shkoje per, Rishikimin rregullisht te vetë Proçesit te vetëvlerësimit, duke e përshtatur ne cdo kohe atë bazuar në reagimet dhe nevojat në ndryshim.</p> <p>Njeheresh do te qëndrojmë në dijeni dhe te gatshem per implementim të ndryshimeve në standardet e auditimit dhe praktikat më të mira për të siguruar që vetëvlerësimi të mbetet I rëndësishëm dhe efektiv.</p>
--	--------------------------------------	--

**NJESIA E AUDITIMIT TE BRENDSEHEM
ADRIATIK CARKA**